KESHILLI I LARTË I PROKURORISË

**RREGULLORE PËR PAGESAT E PROKURORËVE
PËR PUNËN E KRYER JASHTË ORARIT ZYRTAR**

Neni 1
Objekti

Rregullorja për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar (në vijim rregullorja) vendos rregulla të detajuara për kompensimin financiar ose në ditë pushimi që duhet të marrin sipas ligjit magjistratët prokurorë të cilët punojnë jashtë orarit zyrtar, ditët e pushimeve dhe festave zyrtare për shkak të shërbimit të gatishmërisë, masave të sigurimit apo çdo rasti tjetër sipas nevojave të funksionit që buron nga parashikimet e Kodit të Procedurës Penale apo ligje të tjera.

Neni 2
Qëllimi

Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për të sanksionuar rregulla të njëjta për magjistratët prokurorë duke garantuar parimin e barazisë për punën e kryer jashtë orarit zyrtar, ditët e pushimeve dhe festave zyrtare.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në nenin 11, pika 3 gërma ç të ligjit Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në nenin 189, pika 1, gërma "c" të

Ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe në nenet 4, 90 dhe 91 të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar.

Neni 4
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë magjistratët prokurorë të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5
Parimet

Parimi i barazisë: çdo magjistrati prokuror i njihet e drejta të ketë kompensim financiar ose kompensim në ditë pushimi për punën e kryer jashtë orarit zyrtar, gjatë ditëve të pushimit dhe ditëve të festave zyrtare.

Neni 6
Puna jashtë orarit zyrtar

1.Konsiderohen punë jashtë orarit zyrtar, puna e kryer ditën e shtunë dhe ditën e dielë, gjatë ditëve të festave zyrtare sipas përcaktimeve të bëra në Vendime të Këshillit të Ministrave dhe jashtë orarit zyrtar.
2. Kohëzgjatja ditore normale e punës konsiderohet jo më shumë se 8 orë.
3. Konsiderohet punë e kryer gjatë orarit zyrtar, puna e kryer nga ora 08.00 deri në orën 16:00.

Neni 7
Mënyrat e kompensimit

1.Prokurori që ushtron funksionin jashtë orarit zyrtar, në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare përfiton kompensim financiar me shtesë page mbi pagën normale të tij ose kompensim me kohë pushimi.
2.Prokurori që ushtron funksionin në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare si dhe orët shtesë të kryera në orarin 22.00 – 06.00, përfiton shtesë page në masën 50 % të pagës së tij ditore ose kompensim me kohë pushimi.
3.Prokurori që ushtron funksionin jashtë kohës normale të punës përfiton shtesë page në masën 25% të pagës së tij ditore ose kompensim me kohë pushimi.
4.Drejtuesi i Prokurorisë do të kompensojë financiarisht prokurorët sipas përcaktimeve në pikën 2 dhe 3 të këtij neni. Në rastin e pamundësisë së kompensimit financiar atëherë prokurori do të

kompensohet me kohë pushimi në rastet kur e sheh të mundur, me një pushim të paktën 25% më të madh (në rastin e orëve jashtë orarit zyrtar) që i korrespondon kohëzgjatjes së orëve shtesë dhe 50% më të madh (në rastin e punës në ditët e festave zyrtare apo pushimit javor, të shtunë ose të dielë) që jepet brenda 1 muaji nga dita e kryerjes së punës.

Neni 8
Shërbimi i gatishmërisë

1.Prokurori që është në gatishmëri sipas grafikut të përcaktuar nga drejtuesi i prokurorisë gjatë ditëve të javës por për shkak të gatishmërisë punon gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve pushim, përfiton kompensim financiar ose kompensim me kohë pushimi sipas pikës 2 ose 4 të nenit 7.
2.Prokurori i cili është i gatshëm gjatë ditëve të javës por për shkak të gatishmërisë del jashtë orarit zyrtar të asaj dite përfiton kompensim financiar ose kompensim me kohë pushimi në përpjestim me orët e punës së kryer sipas pikës 3 ose 4 të nenit 7.
3.Prokurori për pikat 1) dhe 2) të këtij neni duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer.

Neni 9

Fondet e miratuara

Prokuroria duhet të ketë fonde të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të saj. Fondi i përcaktuar për orët jashtë orarit nuk duhet të tejkalojë më shumë se 200 orë në vit per çdo prokuror.

Neni 10
Dispozita kalimtare

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj rregulloreje fillojnë që nga data 1 Janar 2019.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e botimit në fletoren zyrtare.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË